# DËSHMI ARKIVI

**A-469272**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Incidenti në Nju Jork, reagon Rama: Nuk ka baltë, vezë dhe jargë që më ndalë në misionin për të ngritur sa më lart flamurin kombëtar – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/incidenti-ne-nju-jork-reagon-rama-nuk-ka-balte-veze-dhe-jarge-qe-me-ndale-ne-misionin-per-te-ngritur-sa-me-lart-flamurin-kombetar/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:46:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:41:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `52520db26f8904405558bd5c29722cd03b8f3b799bccbf73d24f8b1f48381786` |
| TEKSTI | `c5d8a4950db43843bb851eaed5c6416c72105c56761b7835d6818ed7c5345f23` |
| PAMJA | `1203568c90e9841ce02f5c308ac7274d04c8d670ffff5659e75f06c4ca290a9e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3a745f6216efab673958bdaaf9a1b61b11abd6914cdd2aa048db22f40c90dd30` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3a745f6216efab673958bdaaf9a1b61b11abd6914cdd2aa048db22f40c90dd30`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryeministri Edi Rama ka reaguar përmes rrjeteve sociale, pas incidentit të një dite më parë në Nju Jork, ku u sulmua në rrugë me vezë nga disa shqiptarë.

Në reagimin e tij, Rama thekson se nuk ka baltë, vezë dhe jargë që do ta ndalë atë në misionin për të ngritur sa më lart flamurin kombëtar.

“Këtyre që mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike, u them vetëm se atë flamur e kam ngritur më lart se ç’ka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës. Kurse atyre që kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë, në misionin tim për ta çuar flamurin tonë në majën e Europës së Bashkuar, u them se nëse për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi, kjo është një arritje e madhe që nuk ka rënë nga qielli, po ka ardhur pikërisht si një nga rezultatet e këtij misioni!”, shkruan Rama.

Kryeministri thekson gjithashtu se sot në Shqipëri ka tjetër standard. Koha kur vendi i zhytur në korrupsion nuk ekziston më, pasi sot të gjithë janë të barabartë para ligjit.

REKLAMË

Postimi i Ramës:

Këtyre që mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike, u them vetëm se atë flamur e kam ngritur më lart se çka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës. Kurse atyre që kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë, në misionin tim për ta çuar flamurin tonë në

bullgar nga Pusteci: Shqipëria në BE...

5 Me skafandër në kokë dhe armë në dorë, foto e autorit të dyshuar të...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

majën e Europës së Bashkuar, u them se nëse për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi, kjo është një arritje e madhe që nuk ka rënë nga qielli po ka ardhur pikërisht si një nga rezultatet e këtij misioni!

Dhe le ta dëgjojnë e ta mbajnë mirë vath në vesh meqë kujtojnë se mposhtem unë dot me "bombat çudibërëse" që amplifikojnë në kupë të qiellit ditë e natë fjalën korrupsion:

Në një vend që është i mbytur në kënetën e korrupsionit, nuk ka luftë frontale e as rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe atë vend e kemi jetuar ne, që të gjithë, deri kur unë me partinë time e kthyem rrotën e drejtësisë nga barazia e të gjithëve para ligjit!

Sot Shqipëria nuk është më ai vend e prandaj edhe Bashkimi Europian e çmon gjithnjë e më shumë Shqipërinë për këtë luftë, ndërkohë që pulat histerike të katundit tonë kakarisin e hedhin vezë në ajër për llogari të gjelave tallagjarë të pazarit politik e mediatik, të cilët i gënjen mendja sa një vezë, se do të më ndalin mua me llogjet e pafundme për korrupsionin që po luftohet nga vetë sistemi që po ndërtojmë, apo me sharjet e mallkimet folklorike si të këtij sqepit bashkëngjitur, që e shkruan shqipen me këmbët e pulës😁

#Incidenti #NjuJork #rama #veze #VizionPlus


WRITTEN BY
**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus



Të gjithë artikujt →


## Vazhdo të lexosh




POLITIKË
**Rama: E vërteta është rrezikuar nga e keqj...**
Taulant Halili 25 Sht 16:29



POLITIKË
**"Shqipëria ka ndryshuar", Rama...**
Ana Miha 25 Sht 16:18



POLITIKË
**"Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin", Ra...**
Ana Miha 25 Sht 16:12



REKLAMË


## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.